



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**



**RAPORT  
I INSPEKTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM MBI VLERËSIMIN E  
ANGAZHIMEVE POLICORE NË KUADRIN E MASAVE  
PARANDALUESE TË AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE NË  
LUFTIMIN E COVID-19**

Nr. 1/2020

Prishtinë, 22 prill 2020

## Informata të përgjithshme

---

<b>Titulli</b>	Raport i inspektimit të jashtëzakonshëm mbi vlerësimin e angazhimeve policore në kuadrin e masave parandaluese të autoriteteve përgjegjëse në luftimin e Covid-19
<b>Data e përgatitjes</b>	22 prill 2020
<b>Përgatitur nga</b>	Ilir Idrizaj, udhëheqës i ekipit të inspektimit, Kushtrim Jonuzi, inspektor, Xhavit Fetahaj, inspektor
<b>Mbështetur nga</b>	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>Dorëzuar nga</b>	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	Miradije Kelmendi, Kryeshf Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Data e miratimit</b>	22 prill 2020



### 1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-4)

### 2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(5-5)  
2.2. Qëllimi i inspektimit.....(5-5)  
2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit.....(5-5)  
2.4. Objektivat e inspektimit.....(5-5)  
2.5. Rëndësia e inspektimit.....(6-6)  
2.6. Metodologjia e inspektimit.....(6-6)  
2.7. Periudha e realizimit dhe mbulimit të inspektimit.....(6-6)  
2.8. Drejtimit e inspektimit.....(6-6)  
2.9. Kriteret e vlerësimit.....(6-6)  
2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(6-6)

### 3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1 Pasqyrë e ngjarjeve që lidhen me pandeminë Covid-19.....(7-8)  
3.2 Zbatimi i masave parandaluese në zonat e karantinuara.....(8-16)  
3.3 Aktiviteti policor në stacionet policore kufitare.....(17-18)

### 4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(19-19)

Shtojca

## 1. Përmbledhja ekzekutive

---

### 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Në vazhden e reagimit për të ndërmarrë masat e sigurisë në kompetencë të Policisë së Kosovës lidhur me masat parandaluese të autorizuara nga institucionet shëndetësore e qeveritare, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka lëshuar Urdhër Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virusin Covid-19. Konform Urdhrit në fjalë edhe Drejtoritë Rajonale Policore kanë hartuar plane, përmes të cilave kanë planifikuar organizimin e funksionimin e kapaciteteve të tyre policore, bashkëpunimin ndër-institucional me institucionet shëndetësore, komunat dhe akterët tjerë, si dhe ndërmarrjen masave parandaluese bazuar në vendimet e autoriteteve përgjegjëse.

1.1.2. Gjatë inspektimit është vërejtur se stacionet policore që kanë kontrolluar ndalimin e lëvizjes në zonat e karantinuara kanë pasur kapacitete të mjaftueshme të burimeve njerëzore, ngase sipas nevojave janë mbështetur edhe me njësi shtesë nga drejtoritë tjera policore. Duke vlerësuar situatën e krijuar nga pandemia me Covid-19, stacionet policore kanë aktivizuar kapacitetet njerëzore operative me orar 12 orësh. Stacionet kanë vënë theks në vendosjen e pikave statike për kontroll dhe ndalim të hyrje-daljeve në zonat e karantinuara. Përmes patrullimeve kanë pasur në fokus edhe përcjelljen e situatës, parandalimit të rasteve dhe monitorimin e zbatimit të vendimeve të Qeverisë dhe institucioneve shëndetësore për kufizimin e lirisë së lëvizjes në zonat e tyre të përgjegjësisë.

1.1.3. Për të verifikuar zbatimin e masave të kontrollit dhe ndalimit të hyrje-daljeve në zonat e karantinuara, IPK-ja ka realizuar një numër vizitash në disa zona të përgjegjësisë të stacioneve policore ku brenda tyre janë hapur zonat karantinë. Inspektorët kanë hasur se një numër patrullash policore nuk kanë arritur të zbatojnë sa duhet masat parandaluese, duke mos reflektuar përkushtim dhe seriozitet për kryerjen e detyrave në zbatimin e masave dhe vendimeve të organeve. Kjo shtron nevojën që drejtuesit e stacioneve të ngritin masat e kontrollit ndaj patrullave, në mënyrë që të shtohet vigjilenca në kufizimin e qasjes dhe lëvizjes së individëve, duke minimizuar shpërndarjen e virusit te qytetarët. Nuk duhet lënë anash edhe vërejtjet lidhur me disa situata kur udhëzimet për zyrtarët policor në terren janë konsideruar si të pazbërthya sa duhet dhe në këtë drejtim kërkohet nga mbikëqyrësit që me rastin e ndarjes së detyrave, të sigurohen se vartësit i kanë kuptuar qartë.

1.1.4. IPK-ja ka evidentuar edhe disa vështirësi apo pengesa për të siguruar një mbikëqyrje efektive policore në zonat e karantinuara, përshkak se pozita apo vendet ku janë gjetur patrullat policore të vendosura, nuk sigurojnë kontroll të duhur, andaj autoritetet policore duhet të analizojnë situatat e tilla në mënyrë që patrullat të mund të sigurojnë mbikëqyrje efektive të rrugëve, përmes të cilave mund të minimizohet lëvizja e qytetarëve dhe automjeteve. Veç tjerash janë identifikuar edhe rrugë apo shtigje të pambuluara me prani policore, përmes të cilave mund të kihet qasje në karantina.

1.1.5. Gjatë inspektimit janë identifikuar raste kur zyrtarët policor në kuadër të patrullave policore të angazhuar në zbatimin e masave parandaluese, nuk kanë respektuar masat mbrojtëse, duke rrezikuar të jenë të ekspozuar ndaj rrezikut të infektimit me Covid-19. Në këto raste janë vërejtur neglizhime në përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, përfshirë maskat, dorëzat dhe dezinfektuesit. Inspektorët kanë hasur se stacionet policore ballafaqohen me furnizime të kufizuara të pajisjeve mbrojtëse, çka shumë shpesh punonjësit detyrohen t'i sigurojnë vet ato. Kurse, dezinfektimet e hapësirave dhe automjeteve në shumicën e rasteve nuk janë të rregullta dhe kjo shtron nevojën për ndërmarrjen e veprimeve parandaluese në ngritjen e sigurisë së punonjësve.

## **2. Hyrje**

---

### **2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit**

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Duke u bazuar në legjislacionin aktual, përveç inspektimeve që iniciohen bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, IPK-ja zhvillon po ashtu edhe inspektime të jashtëzakonshme që mund të rrjedhin si kërkesë e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme. Bazuar në këtë, më 7 prill 2020, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar respektimin e rregullave nga Policia e Kosovës në zbatimin e masave parandaluese kundër infeksionit nga Covid-19 në përputhje me vendimet e autoriteteve përgjegjëse për zonat karantinë. Ky inicim ka ardhur pas kërkesës së Ushtruesit të detyrës së Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, z. Xhelal Sveçla. Lidhur me këtë, ditëve të fundit është raportuar nga disa medie mbi vështirësitë në menaxhimin e situatës, krahas obligimeve që ka marrë Policia e Kosovës në zbatimin e masave parandaluese rreth Covid-19. Vlerësimi i kësaj fushe paraqet interes për vlerësimin e angazhimeve policore në ndërmarrjen e masave të nevojshme parandaluese.

### **2.2. Qëllimi i inspektimit**

2.2.1. Qëllimi i inspektimit është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saja;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat;
- Që të jepet mendim objektiv mbi masat e ndërmarra në respektimin e rregullave gjatë kryerjes së detyrave në këtë periudhë pandemie;
- Që të parandalojë shkeljet që mund të kryhen gjatë punës në angazhime të kësaj natyre;
- Që të identifikojë mangësitë/dobësitë dhe të rekomandojë masa adekuate për funksionim më të mirë policor.

### **2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit**

2.3.1. Në këtë inspektim të jashtëzakonshëm janë vlerësuar angazhimet policore në kuadrin e masave parandaluese të autoriteteve përgjegjëse në luftimin e Covid-19. Inspektimi është fokusuar në zonat e karantinës të mbikëqyrura nga stacionet përkatëse policore dhe pikëkalimet kufitare.

### **2.4. Objektivi i inspektimit**

2.4.1. Objektivat që synon të arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike në realizimin e planeve operative për gatishmëri dhe reagim kundër Covid-19;
- Vlerësimi i ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme policore në zbatimin e vendimeve të autoriteteve përgjegjëse për aplikimin e masave parandaluese që lidhen me Covid-19;
- Vlerësimi i ndërmarrjes së masave parandaluese nga radhët policore gjatë kryerjes së detyrave dhe përmbushjes së planeve operative.

## **2.5. Rëndësia e inspektimit**

2.5.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në shtimin e masave të sigurisë, në drejtim të aplikimit të masave parandaluese;
- Ngritjen e transparencës dhe besueshmërisë së qytetarëve ndaj punës policore;
- Identifikimin e nevojave dhe kërkesave që shtojnë para arritjen e objektivave.

## **2.6. Metodologjia e inspektimit**

2.6.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar takime-intervista me punonjës përgjegjës të strukturave policore;
- b) Janë kryer kontrolle-inspektime fizike të njërive policore në zonat e karantinuara;
- c) Janë siguruar dhe marrë urdhrat operativ, planet operative, oraret e ndërrimeve, raportet e mbikëqyrësve, logjet ditore dhe raportet tjera mbi ecurinë e zbatimit të masave.

## **2.7. Periudha e realizimit dhe mbulimit të inspektimit**

2.7.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 08.04.2020 dhe ka përfunduar me datë 10.04.2020. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave nga stacionet përkatëse gjatë periudhës kohore nga 11.03.2020 deri në ditën e inspektimit.

## **2.8. Drejtimit e inspektimit**

2.8.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Urdhrat dhe planet operative;
- Kapacitetet njerëzore dhe teknike;
- Aktivitetet policore në kufizimin e lëvizjes në zonat e karantinës;
- Masat parandaluese policore.

## **2.9. Kriteret (standardet) e vlerësimit**

2.9.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave policore:

- Ligji i Policisë;
- Rregullorja për Operativë në Policinë e Kosovës;
- Vendimet e Qeverisë së Kosovës lidhur me parandalimin e infeksionit nga Covid-19;
- Urdhrat dhe planet operative policore.

## **2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave**

2.10.1. IPK-ja gjatë punës në terren nuk ka hasur në vështirësi që mund të ndikonin në përmbushjen e objektivave të inspektimit. Inspektorët kanë realizuar inspektimin bazuar në metodologjinë e përcaktuar me Programin e punës inspektuese.

### 3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

---

#### 3.1. Pasqyrë e ngjarjeve që lidhen me Pandeminë Covid-19

3.1.1. Në kohën kur Coronavirus (Covid-19) është përhapur në të gjitha kontinentet duke marrë shumë jetëra njerëzish, vigjilenca dhe qasja multidisiplinare ndaj kësaj emergjence është tejet e domosdoshme. Për marrjen e masave dhe veprimeve parandaluese në vendin tonë, qysh në muajin e parë të këtij viti me Vendimin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 05/20, të datës 31 janar 2020 është formuar Komiteti për monitorim të sëmundjeve ngjitëse për hartimin e Planit të gatishmërisë dhe reagimit kundër Coronavirus të ri Covid-19, sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë/Rajoni i Evropës. Ky dokument është hartuar mbi rekomandimet e OBSH-së dhe European Center for Disease Control<sup>1</sup> për situatën me Coronavirus të ri Covid-19 dhe si i tillë mund të ndryshohet varësisht prej situatës epidemiologjike në vend dhe atë globale. Në këtë proces të angazhimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve ndër-institucionale, krahas akterëve tjerë pjesëmarrës në këtë Plan të gatishmërisë, si akter kyç është përfshirë edhe Policia e Kosovës, e cila në bazë të autorizimeve dhe kompetencave ligjore që ka është e obliguar t'i ndërmerret të gjitha veprimet operative për mbështetje dhe realizim të këtij Plani.

3.1.2. Me qëllim të parandalimit të infeksionit, me kërkesë të Ministrit të Shëndetësisë, Qeveria e Kosovës më 11 mars 2020 ka nxjerrë Vendimin për ndërmarrjen e masave parandaluese deri më 27 mars 2020, duke ndërprerë procesin edukativo-arsimor, duke pezulluar përkohësisht linjat e udhëtimit ajror dhe tokësor nga vendet me risk të lartë dhe të mesëm, për kontrollin e obliguar të udhëtarëve nga ekipet mjekësore në të gjitha hyrje daljet e Kosovës, vetëkarantinim të detyruar për të gjithë qytetarët që hyjnë në Republikën e Kosovës nga zonat epidemike, si dhe ndërprerjen e kufizimit të shumë aktiviteteve dhe veprimtarive që paraqesin rrezik për përhapjen e virusit.

3.1.3. Varësisht rrjedhës së kërcënimit dhe përkeqësimit të situatës pas shfaqjes së rasteve të të infektuarve me virusin Covid-19 në vendin tonë, duke filluar nga data 13 mars 2020, Qeveria ka nxjerrë edhe vendime tjera për vazhdim dhe ashpërsim të masave që kufizojnë lëvizjen e qytetarëve, kufizimin dhe ndërprerjen e veprimtarive të shumta, përveç atyre vitale që janë në shërbim të sigurisë, parandalimit dhe luftimit të pandemisë<sup>2</sup>. Në kuadër të këtyre masave, me vendim të Qeverisë së Kosovës janë shpallur zona të karantinuara edhe disa komuna, ku u ndaluan hyrje-daljet e qytetarëve në këto zona, si dhe u shpallë emergjenca për shëndetin publik.

3.1.4. Më 19 mars 2020, me vendim të Ushtresit të Detyrës të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP) është aktivizuar Plani i Reagimit Kombëtar në kuadër të së cilit përfshihet themelimi i Grupit Ndër-institucional për Menaxhimin e Incidenteve. Në kuadër Grupit janë përfshirë bartësit e ministrive të linjave, të disa agjencive, ndër to edhe të Policisë së Kosovës. Në bazë të këtij Plani, Grupi Ndër-institucional për Menaxhimin e Incidenteve nën kordinimin e Ushtresit të Detyrës së Ministrit të MPBAP-së është i obliguar t'i kryejë detyrat dhe përgjegjësitë bazuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Planin e Reagimit Kombëtar dhe legjislacioni tjetër përkatës në fuqi.

---

<sup>1</sup> Qendra Evropiane për Kontrollin e Sëmundjeve.

<sup>2</sup> Vendimet nr. 01/08 (datë 12.03.2020), nr. 01/09 (datë 13.03.2020), nr. 01/10 (datë 14.03.2020), nr. 01/11 (datë 15.03.2020), nr. 01/13 (datë 18.03.2020), nr. 01/18 (datë 18.03.2020), nr. 01/22 (datë 05.04.2020).

3.1.5. Në saje të autorizimeve që dalin nga Ligji për Policinë, obligimeve që dalin nga Plani për Gadishmëri dhe Reagim kundër Corona Virus Covid-19 dhe me qëllim të zbatimit të masave parandaluese që ka përcaktuar Qeveria me Vendimin e datës 11 mars 2020 për parandalimin dhe mbrojtjen nga infeksionet e mundshme me virusin në fjalë, Policia e Kosovës më 12 mars 2020 ka lëshuar Urdhër Operativ për Gadishmëri dhe Reagim për Corona Virus-in Covid-19 që ka për qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve me institucionet qendrore dhe lokale që janë kompetente për luftimin, preventimin e rreziqeve nga ky virus, përgaditjen paraprake të planeve operacionale për përballje me situatën, krijimin dhe zhvillimin e kontakteve të bashkëpunimit dhe harmonizimin e veprimeve të përbashkëta me institucione shëndetësore, agjencitë dhe institucionet tjera. Duke marrë për bazë zhvillimet me këtë virus, rrezikun dhe pasojat për qytetarët, Policia e Kosovës ka vlerësuar në nivel vendi rrezikun e nivelit *të mesëm*, mirëpo që mund të ndryshojë varësisht nga përhapja apo e kundërta e këtij virusi. Sipas Urdhrit, secila Drejtori Rajonale Policore (DRP) brenda zonës së përgjegjësisë është përgjegjëse për të menaxhuar situatën e krijuar.

3.1.6. Urdhri Operativ ka përcaktuar që DRP-të të përpilojnë plane mbi angazhimet operacionale, të caktojnë drejtorët rajonal si udhëheqës të përgjithshëm në nivel rajonal, udhëheqësit operacional nga Operativa dhe komandantët e stacioneve si udhëheqës në nivel lokal. IPK gjatë inspektimit të stacioneve policore ka arritur të sigurojë se në kuadër të DRP-ve janë hartuar plane, me të cilat është përcaktuar organizimi i strukturave në kuadër të tyre, duke përcaktuar ndarjen e detyrave e funksioneve të të gjitha stacioneve për angazhim operacional në menaxhimin e situatës brenda zonave të përgjegjësisë. IPK çmon angazhimin e strukturave policore për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme përgaditore për menaxhimin e situatës dhe njëherit i inkurajon që në vazhdimësi të jenë vigjilent për veprim në përputhje me rrethanat që i imponon rrjedha e ngjarjeve në këtë situatë.

3.1.7. Fokus i inspektimit ka qenë që të vlerësohet performanca e njërive patrulluese policore në sigurimin e perimetrit të zonave të karantinuara, nëse ato zbatojnë masat dhe vendimet e Qeverisë për parandalimin e përhapjes së kësaj pandemie, gjithnjë duke respektuar edhe rekomandimet e institucioneve shëndetësore. Gjatë këtij inspektimi janë inspektuar disa nga zonat e karantinuara<sup>3</sup> (Malishevë, Klinë, Viti, Topanicë, Korishë, Dumnicë, Smrekovnicë, Zveçan, Mitrovicë Veriu, etj). Kurse, për të vlerësuar aplikimin e masave parandaluese nëpër pikëkalimet kufitare janë inspektuar edhe katër (4) stacione policore kufitare (Vërmicë, Merdare, Bërnjak dhe Dheu i Bardhë).

## 3.2. Zbatimi i masave parandaluese në zonat e karantinave

3.2.1. Stacioni Policor i Malishevës duke u bazuar në Planin Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virus Covid-19, të hartuar nga DRP-Gjakovë, ka hartuar plane veprimi mbi aktivitetet policore me qëllim të zbatimit të masave kundër virusit në fjalë, bashkëpunimin me institucionet lokale shëndetësore dhe me komunën, në mënyrë që të planifikohen të gjitha masat e nevojshme policore për situatën e krijuar. Pas raportimeve se më 14 mars 2020, një qytetare e Komunës së Malishevës është infektuar me Covid-19, Qeveria e Kosovës ka marrur vendim për bllokimin e hyrje-daljeve në Komunën e Malishevës. Meqenëse kjo Komunë ishte shpallur zonë e karantinës sipas Vendimit të Qeverisë nr. 01/15, Stacioni Policor-Malishevë ka planifikuar numrin e zyrtarëve policor për të mbuluar zonën për ndalim të qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve, me qëllim të pengimit të shpërndarjes së virusit. Krahas mobilizimit të personelit të Stacionit, i njejtë është mbështetur me njësi shtesë nga DRP-Gjakovë dhe NJRSH-Mitrovicë. Me detyra policore është

<sup>3</sup> Hapësira ku kufizohet lëvizja e personave, të cilët nuk janë të sëmurë, por janë objekt i infeksionit.



angazhuar edhe stafi policor i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë që vie nga kjo komunë. IPK-ja ka siguruar oraret ditore të angazhimit të fuqisë punëtore për kryerjen e detyrave dhe aktiviteteve policore. Gjatë tetë (8) ditëve të fundit nga data 1 prill deri 8 prill 2020, aktivitetet e nxjerra nga Aneks Plani i Veprimit ka përfshirë në oraret e stacionit punën me dy (2) ndërrime nga 12 orë, duke përfshirë ndarjen e njërive dhe caktimin e fuqisë punëtore për të realizuar aktivitetet policore. Bazuar në orarin e ndërrimit të datës 8 prill 2020 kur është realizuar inspektimi, për të mbuluar zonën e përgjegjësisë janë angazhuar dhjetë (10) patrulla policore, prej tyre, gjashtë (6) patrulla në pika statike për të mbuluar perimetrin e jashtëm të komunës dhe katër (4) ekipe patrulluese në pika statike nëpër lagje ku ishin konfirmuar raste të të infektuarve.

3.2.2. Gjatë inspektimit të patrullave policore që sigurojnë perimetrin e zonës së karantinës të Komunës së Malishevës janë inspektuar gjashtë (6) patrulla të vendosura nëpër pika statike në të gjitha nyjat kryesore që lidhin territorin e kësaj komune me zona të komunave tjera. Lokacionet e këtyre patrullave kanë qenë në akset rrugore Malishevë-Prishtinë (Tërpezë), Malishevë-Rahovec (Astrazub), Malishevë-Suharekë (Pagarushë), Malishevë-Gjakovë (Llapqevë), Malishevë-Klinë (Udhëkryqi i Klinës) dhe tek Nyja e Autostradës (Banjë). Të gjitha patrullat policore janë gjetur në lokacionet e parapara me plan dhe orarin ditor të angazhimit. Në bazë inspektimit, performanca e kryerjes së detyrave nga njësitë në sigurimin e zonës së karantinuara të Malishevës vlerësohet në nivelin jo të kënaqshëm. Është vërejtur se patrullat policore ballafaqohen me vështirësi duke patur parasysh tendencën e qytetarëve për të lëvizur brenda dhe jashtë zonës së karantinuara me arsyetime dhe nevoja të ndryshme. Pastaj, nëpër zonë të përgjegjësisë ka edhe shtigje tjera si rrugë rurale, të cilat me kapacitetet aktuale policore është e pamundur të mbulohen. Inspektorët kanë vrojtuar angazhimet e një patrulle tek Udhëkryqi i Kijevës dhe kanë vërejtur hyrje-dalje të konsiderueshme të automjeteve në zonën e karantinuara. Inspektorët kanë shprehur shqetësimin e tyre dhe kanë kërkuar sqarim nga zyrtarët policor për gjithë atë qarkullim brenda dhe jashtë zonës. Zyrtarët policor kanë arsyetuar se pozita ku është caktuar pika statike, ndanë fshatin Kijevë në mes dhe se në tre anët e rrugës ka banorë të këtij fshati. Sipas tyre, banorët kanë nevoja të arsyeshme ku shumica kërkojnë të shkojnë tek ambulanca e fshatit që ishte brenda zonës, pastaj kanë kërkesa për furnizim me gjëra ushqimore në dyqanet që gjenden aty rreth atij kryqëzimi. Lidhur me këtë IPK vlerëson se patrulla policore e vendosur aty, nuk arrinë të kufizojë qarkullimin e qytetarëve brenda dhe jashtë zonës karantine. Kjo çështje duhet adresuar menjëherë, në mënyrë që drejtuesit t'i ndërmarrin masat e nevojshme për eliminimin e këtyre rrjedhjeve, duke krijuar kushte që masat e parandalimit të përcaktuara nga Qeveria të respektohen në përpikëri.

3.2.3. Fokus i inspektimit ka qenë edhe aplikimi i masave mbrojtëse nga ana e zyrtarëve policorë. Gjatë takimit me zyrtarë policor të patrullave të Stacionit Policor të Malishevës, janë deklaruar se jo rregullisht kanë mundësi të pajisen me pajisje mbrojtëse (maska, dorëza dhe dezinfektues) të mjaftueshme nga shërbimi. Shumë prej tyre janë deklaruar se shpesh pajisjet e tilla detyrohen t'i sigurojnë vetë. Edhe sa i përket dezinfektimit të automjeteve ata kanë deklaruar se nuk po aplikohet dezinfektim i rregullt i tyre. Fokus i inspektimit ishte edhe aplikimi i masave mbrojtëse nga zyrtarët policor të patrullave policore, duke i kushtuar kujdesin e duhur përdorimit të pajisjeve mbrojtëse (maska dhe dorëza). Gjatë inspektimit të patrullave policore që sigurojnë perimetrin e zonës është vërejtur se në masë të madhe personeli aplikon përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, përveç patrullës policore në Udhëkryqin e Kijevës, ku zyrtarët policor nuk kanë pasur pajisje me arsyetimin se nuk janë furnizuar.

3.2.4. Stacioni Policor i Vitisë duke u bazuar në Planin Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virusin Covid-19 të hartuar nga DRP-Gjilan, më 12 mars 2020 ka hartuar Planin Operativ në nivel stacioni, i cili vazhdon të mbikëqyret nga Komandanti i stacionit si udhëheqës në nivel lokal. Pas paraqitjes së rasteve të para me Covid-19 që lidhet me disa të ardhur nga Italia në fshatin Stubëll të Vitisë, krahas institucioneve shëndetësore edhe Stacioni Policor i Vitisë është mobilizuar në menaxhimin e situatës së sigurisë brenda Komunës së Vitisë si një zonë e shpallur nga Qeveria si karantinë. Stacioni Policor i Vitisë është përkrahur edhe me ekipe shtesë nga NJRKRR-Gjilan dhe Stacioni Policor i Kllokotit. IPK-ja ka inspektuar këtë stacion dhe patrullat e saj policore në terren për të vlerësuar angazhimet në këtë periudhë pandemie. Sipas orareve të siguruar është vërejtur se janë të angazhuara tre ekipe policore me rreth 20 punonjës për secilin ndërrim 12 orësh. Në ditën kur është inspektuar ndërrimi A, Stacioni ka pasur të angazhuar dhjetë (10) patrulla, nga të cilat dy (2) kanë operuar si patrulla statike, tre (3) patrulla në këmbë dhe pesë (5) patrulla mobile. Dy (2) patrullat statike janë të përhershme dhe operojnë në dy pika hyrëse jashtë qytetit të Vitisë në akset rrugore Kllokot-Viti dhe Gërllicë-Viti, kurse patrullat tjera operojnë në pjesë të ndryshme të komunës dhe të vet qytetit.

3.2.5. Gjatë inspektimit të patrullave që sigurojnë perimetrin e zonës së karantinës së Komunës së Vitisë janë inspektuar pesë (5) patrulla të vendosura në pika të ndjeshme dhe lokacione brenda zonës së përgjegjësisë ku vlerësohet e nevojshme nga gjithsej dhjetë (10) sa kanë qenë aktive. Lokacionet e këtyre patrullave kanë qenë në aksin rrugor Gërllicë-Viti (Sadovinë e Jerlive), aksin rrugor Kllokot-Viti (tek udhëkryqi i fshatit Mogillë), brenda qytetit në udhëkryqin Viti-Pozheran, brenda qytetit tek Stacioni i Autobusëve dhe aksin rrugor Kllokot-Ferizaj në qendër të Pozheranit. Pesë (5) patrulla policore kanë qenë në patrullim për të mbuluar perimetrin e zonës së karantinës, por edhe si patrulla në thirrje të rasteve në pjesë të qytetit dhe fshatra të komunës. Në aksin rrugor Viti-Letnicë është vizituar edhe një patrullë e Stacionit Policor të Kllokotit, e cila ishte vendosur si pikë e përhershme për të kufizuar lëvizjet për në fshatin Stubëll. Nga inspektimi është vërejtur se kapacitetet njerëzore janë të mjaftueshme, por është e nevojshme të analizohet nëse ka nevojë të ndryshohet lokacioni i pikës statike në aksin rrugor Gërllicë-Viti tek fshati Sadovinë e Jerlive, për të pozicionuar këtë pikë më në brendësi të fshatit përgjatë rrugës kryesore, ngase mund të ketë rrjedhje apo qarkullim nga rruga që lidhë fshatin Dardani të Komunës së Ferizajt me qytetin dhe fshatrat e Komunës së Vitisë, rrugë e cila krijon një kanal qarkullimi të papengueshëm me qytetin e Ferizajt dhe më gjërë.

3.2.6. Gjatë inspektimit të realizuar në Stacionin Policor të Vitisë, inspektorët janë njohur edhe me vështirësitë për t'u pajisur rregullisht me pajisje mbrojtëse që shpesh detyrohen t'i sigurojnë vetë. Sipas drejtuesve të stacionit, deri në ditën e inspektimit tre herë është dezinfektuar objekti i stacionit. Inspektimi i patrullave policore të Stacionit Policor të Vitisë pasqyron një mobilizim në aplikimin e masave mbrojtëse kundër Covid-19. Patrullat janë gjetur duke aplikuar vendosjen e maskave dhe dorëzave mbrojtëse.

3.2.7. Stacioni Policor i Podujevës duke u bazuar në Planin Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virus-in Covid-19 të hartuar nga DRP-Prishtinë, ka hartuar plane veprimi lidhur me planifikimin e aktiviteteve, bashkëpunimin ndër-institucional dhe masat që duhet ndërmarrë. Pas raportimit të datës 15 mars 2020 se në zonën e fshatit Dumnicë të Komunës së Podujevës ishte shfaqur i infektuari i parë me Covid-19, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës kishte urdhëruar DRP-Prishtinë dhe Stacionin Policor në Podujevë që zona e Dumnicës së Epërme dhe

të Poshtme të vendosen në karantinë. Është kërkuar nga strukturat policore të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme policore përmes vendosjes së prezencës policore në hyrje-dalje të këtyre fshatrave. Meqenëse territori i këtyre fshatrave ishte në karantinë, Stacioni Policor i Podujevës ka planifikuar dhe aktivizuar fuqinë punëtore për mbulimin e zonës për ndalim të qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve, me qëllim të kufizimit të lëvizjes së personave potencialisht të infektuar. Krahas mobilizimit të personelit të stacionit, këtë fundit e ka mbështetur DRP-Prishtinë me personel shtesë prej pesë (5) zyrtarëve policor dhe me dy (2) automjete. IPK ka siguruar oraret ditore të angazhimit të fuqisë punëtore dhe ka vërejtur se ekipet kanë punuar në ndërrime 12 orësh. Duke u bazuar në orarin e ndërrimit A të paraditës të datës 9 prill 2020, në mbulimin e zonës së përgjegjësisë janë aktivizuar dhjetë (10) patrulla policore, prej tyre tre (3) patrulla në pika statike të cilat e mbulojnë perimetrin e jashtëm të fshatrave Dumnicë e Epërme dhe Dumnicë e Poshtme dhe shtatë (7) patrulla për patrullim, vëzhgim, parandalim të rasteve dhe monitorimin e zbatimit të vendimit për kufizimin e lirisë së lëvizjes nëpër gjithë zonën e përgjegjësisë së Stacionit.

3.2.8. Gjatë inspektimit të patrullave policore që sigurojnë perimetrin e zonës së karantinës së fshatrave Dumnicë e Epërme dhe Dumnicë e Poshtme të Komunës së Podujevës janë inspektuar tre (3) patrulla policore të vendosura nëpër pika statike në të gjitha akset rrugore që shpiejnë në drejtim të këtyre fshatrave. Lokacionet e patrullave kanë qenë në aksin rrugor Dumnicë-Podujevë, Udhëkryqi Dumnicë-Llaushë dhe Udhëkryqi Dumnicë-Dobërdol. Të tre (3) patrullat policore janë gjetur në ato lokacione ku janë përcaktuar me orar. Në bazë vrojtimit të inspektorëve në ditën e inspektimit, performanca e kryerjes së detyrave nga këto njësi në sigurimin e zonës së karantinuar vlerësohet e kënaqshme me disa pengesa dhe mangësi në funksionimin e zbatimit të masave për kufizimin e lëvizjes së qytetarëve brenda dhe jashtë zonës. Në ditën e inspektimit është kontrolluar ndërrimi i paraditës i datës 9 prill dhe gjatë vrojtimit të kryerjes së detyrave operative nga patrulla në lokacionin në aksin rrugor Dumnicë-Podujevë është vërejtur se disa automjete që kanë lëvizur nga fshati në drejtim të Podujevës, kanë shfrytëzuar një shteg anësor për t'iu shmangur pikës patrulluese vetëm 100 metra larg saj. IPK vlerëson se patrulla policore e vendosur aty nuk arrin të kufizoj të gjitha lëvizjet e qarkullimit të qytetarëve brenda dhe jashtë zonës karantinë. Në orët e pasditës së datës 9 prill 2020, pas rezultimit të dytë të testeve negative të pacientës së fundit dhe konsiderimit të shërimit të saj, me rekomandim të Qendrës Emergjente Operative të MPBAP-së, fshatrat Dumnicë e Epërme dhe Dumnicë e Poshtme largohen nga karantina, por rekomandohet që Policia të patrullojë në lagjen ku gjendet familja, meqë e njejtja duhet të qëndrojë 14 ditë në izolim.

3.2.9. Patrullat policore të Stacionit Policor të Podujevës kanë deklaruar se jo rregullisht kanë mundësi të pajisen me pajisje mbrojtëse (maska, dorëza dhe dezenfektues) të mjaftueshme nga ana e shërbimit. Disa prej tyre janë deklaruar se shpesh këto pajisje detyrohen t'i sigurojnë vetë. Sa i përket aplikimit të masave mbrojtëse nga zyrtarët e patrullave policore në përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, është vërejtur se personeli policor ka zbatuar në mënyrën e duhur masat mbrojtëse. Ndërsa, sa i përket dezinfektimit të automjeteve policore dhe objektit të stacionit, një gjë e tillë realizohet nga një kompani e kontraktuar nga Komuna, saherë që shtrohet kërkesë për dezinfektim nga ana e Stacionit.

3.2.10. Stacioni Policor në Kamenicë duke u bazuar në Planin Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virus-in Covid-1 të hartuar nga DRP-Gjilan, më 12 mars 2020 ka hartuar Plan veprimi për aktivitetet operative, bashkëpunim ndër-institucional dhe ndërmarrjen e masave parandaluese

në situatën e krijuar. Me vendim të MPBAP-së nr. 16/2020, të datës 30 mars 2020, fshati Topanicë në Komunën e Kamenicës është shpallur zonë në karantinë. Gjatë inspektimit të kësaj zone, inspektorët kanë vërejtur se Policia është duke kryer detyrat konform vendimit në fjalë. Stacioni Policor në Kamenicë, krahas planit operativ ka hartuar edhe plane veprimi ku nga të gjitha njësitë është kërkuar mbulueshmëri më e madhe e zonës së përgjegjesisë, duke pasur parasysh situatën aktuale të ballafaqimit me virusin Covid-19. Gjatë inspektimit, IPK ka siguruar edhe oraret ditore që organizojnë angazhimin e fuqisë punëtore për të kryer detyrat dhe aktivitetet policore. Nga fillimi i zbatimit të masave dhe planeve operative (25 mars 2020), Stacioni Policor-Kamenicë aplikon oraret e ndërrimeve nga 12 orë (08.00-20.00 dhe 20.00-08.00, duke krijuar tre (3) ekipe për funksionim (dy në detyrë, një në pushim).

3.2.11. Lokacionet e katër (4) patrullave policore që kanë siguruar zonën e karantinuuar të fshatit Topanicë kanë qenë në akset rrugore Topanicë-Gjilan-Kamenicë, Topanicë-Koretin, Domurovc-Topanicë, Koretin-Gjilan. Duke u bazuar në orarin e ndërrimit të paraditës të datës 10 prill 2020 për të siguruar zonën e karantinuuar aktive kanë qenë pesë (5) patrulla, ku katër (4) nga to në pika statike kanë mbuluar perimetrin e jashtëm të fshatit Topanicë gjatë 24 orëve. Detyrë e patrullës ka qenë ndalimi i lëvizjes së qarkullimit të qytetarëve dhe automjeteve brenda dhe jashtë zonës dhe kontrollimi i hyrje-daljeve të njerëzve dhe automjeteve, të cilëve iu lejohet qarkullimi brenda dhe jashtë zonës. Në brendësi të fshatit ka qarkulluar një patrullë për vëzhgimin e situatës së sigurisë, parandalimin e rasteve dhe monitorimin e zbatimit të vendimit të Qeverisë për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe kontroll të tubimeve të paarsyeshme të qytetarëve në rrugë. Secila patrullë policore ka operuar në përbërje nga dy (2) zyrtarë policor. Për sigurimin e zonës karantinë në Topanicë janë angazhuar pesë (5) automjete me dhjetë (10) zyrtarë policorë. Gjatë kohës së vrojtimit të ekipit të inspektimit nga afërsia e pikave patrulluese, në hyrje-dalje të fshatit Topanicë është parë se njësitë patrulluese kanë kryer kontrollimin e hyrje-daljeve të njerëzve dhe automjeteve, dhe se hyrje-daljet janë realizuar vetëm me autorizime të organeve kompetente, duke mos u lejuar e nuk është lejuar hyrja dhe dalja e personave të paautorizuar.

3.2.12. Të gjithë zyrtarët policorë në Stacionin Policor në Kamenicë janë të pajisur me maska dhe dorëza. Ndërsa, sa i përket aplikimit të masave mbrojtëse nga ana e patrullave policore, IPK-ja ka verifikuar nëse njësitë policore i kushtojnë kujdesin e duhur përdorimit të pajisjeve mbrojtëse. Gjatë inspektimit të patrullave është vërejtur se në masë të madhe personeli aplikon përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, në përjashtim të ekipës patrulluese (P/2/4), e cila në kohën e inspektimit nuk i ka përdorur mjetet mbrojtëse, me të cilat ka qenë e pajisur.

3.2.13. IPK-ja ka zhvilluar inspektim edhe në Stacionin Policor Jugu - Prishtinë për të vlerësuar angazhimet policore në ndërmarrjen e masave të nevojshme në zonën e karantinuuar të Qendrës së Studentëve në Prishtinë. Ky Stacion bazuar në Planin Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virus-in COVID-19, të hartuar nga DRP-Prishtinë dhe vendimet e nxjerra nga Qeveria, ka hartuar plane veprimi mbi aktivitetet operative, bashkëpunimin me institucionet shëndetësore dhe komunale dhe masat e nevojshme policore për situatën e krijuar. Me Vendim të Qeverisë nr. 01/13, të datës 18 mars 2020, Qendra e Studentëve në Prishtinë është caktuar si hapësirë karantinë. Për të respektuar këtë vendim të Qeverisë, Stacioni me plane veprimi nga njësitë reaguese dhe sektoriale ka kërkuar mbulim më të madh të zonës së përgjegjesisë, duke pasur parasysh situatën aktuale. Krahas mobilizimit të personelit të Stacionit, mbështetje me personel stacioni ka marrë edhe nga

stacionet policore Veriu dhe Qendra në Prishtinë. IPK-ja ka siguruar oraret të angazhimit të fuqisë punëtore, në ndërrime 12 orëshe, përfshirë ndarjen e njërive operative patrulluese. Bazuar në orarin e ndërrimit të datës 10 prill 2020, ditën kur është kryer inspektimi i IPK-së, për mbulimin e zonës së përgjegjësisë janë caktuar 36 zyrtarë policor të ndarë në shtatë (7) ekipe statike policore, të cilat kanë mbuluar perimetrin e Qendrës Studentore të shpallur hapësirë karantine dhe një (1) patrullë policore statike e vendosur para portës hyrëse të Qendrës së Studentëve.

3.2.14. Gjatë inspektimit të ekipeve statike policore që mbulojnë perimetrin e hapësirës karantinë të Qendrës së Studentëve janë inspektuar të shtatë (7) ekipet policore të vendosura në pikat statike, si: ekipi te porta kryesore e hyrje daljeve të Qendrës së Studentëve, ekipi i zyrtarëve policor në hyrjet e konvikteve nr. III, VI, VII dhe VIII, dhe ekipeve policore statike që kanë qëndruar prapa konvikteve në monitorimin-vëzhgimin e tyre. Inspektorët kanë vërejtur se sendet që futeshin në hapësirën e karantinës (Qendrën e Studentëve), fillimisht kontrolloheshin nga patrulla policore statike e cila ishte vendosur para portës hyrëse të Qendrës së Studentëve, e më pas futeshin në hapësirën karantinë, kontrolloheshin, evidentoheshin edhe te porta hyrëse e konvikteve, e më pas merreshin nga vullnetarët dhe përcilleshin në destinacionin e caktuar. Varësisht se në cilin objekt (konvikt) kanë pasur destinacionin, ekipet policore të cilët ishin statike në çdo hyrje të konvikteve edhe njëherë bënin evidentimin para se ato sende të dërgoheshin tek personat që ishin në karantinë. Nga inspektimi i realizuar më 10 prill 2020 në këtë zonë karantine, vlerësohet se performanca e njërive policore në sigurimin e hapësirës së karantinuar ka qenë në nivel shumë të mirë, ngase ekipet kanë qenë strikte në zbatimin e vendimit të Qeverisë, ku brenda hapësirës së karantinuar lejohen të hyjnë vetëm personat e autorizuar (personeli shëndetësor, vullnetarët e stafi i Qendrës).

3.2.15. Ekipet patrulluese policore të cilët ishin inspektuar tek Qendra e Studentëve, shumica kanë pasur të vendosur maskat dhe dorezat, përjashtim bëjnë dy raste ku janë vërejtur që nuk kanë pasur pajisjet e tilla me arsyetimin se i kanë harruar në shtëpi. Pjesëtarët e ekipeve policore të inspektuar, kanë deklaruar se jo rregullisht kanë mundësi të pajisen me pajisje mbrojtëse të mjaftueshme nga ana e shërbimit. Disa prej tyre janë deklaruar se pajisjet shpesh detyrohen t'i sigurojnë vetë. Sa i përket pajisjeve mbrojtëse vlen të ceket se në dispozicion kanë edhe veshje mbrojtëse (medicinale) komplete dhe varësisht prej rasteve-nevojave i përdorin ato. Sa i përket dezinfektimit të Qendrës së Studentëve, në këtë hapësirë dezinfektimi bëhet çdo ditë dhe atë e kryen vetë Qendra.

3.2.16. IPK-ja ka kryer inspektim edhe në zonën karantinë të Klinës. Në Stacionin Policor të Klinës janë në zbatim të Urdhrit Operativ dhe bazuar këtë janë adaptuar veprimet operacionale në terren me orar 12 orësh dhe ka funksionuar me kapacitete të plota operative. Më 13 mars 2020, Qeveria e Kosovës ka vendosur për ndalimin e hyrje-daljeve të qytetarëve në Komunën e Klinës duke shpallur si zonë në karantinë. Stacioni Policor i Klinës ka marrë masa në menaxhimin e situatës duke vënë në zbatim kapacitetet e plota njerëzore dhe jo vetëm, sepse për t'u përballur me situatën e krijuar janë angazhuar edhe dy njësi shtesë, një nga NJRKRR-Pejë dhe një nga Stacioni Policor i Istogut. Pas situatës së krijuar në Komunën e Klinës, Stacioni ka aktivizuar orarin 12 orësh të angazhimit të personelit, duke vendosur edhe pika statike 24 h në mbulim të të gjitha rrugëve hyrëse dhe dalje të qytetit të Klinës me qëllim të zbatimit të vendimit të Qeverisë në parandalimin e pandemisë Covid-19. Pikat të cilat janë inspektuar kanë qenë të kompletuara me personel siç ishte paraparë me orar.

3.2.17. Gjatë inspektimit në terren për verifikimin e zbatimit të masave lidhur me ndalimin e hyrje-daljeve së qytetarëve në zonën karantinë të Komunës së Klinës, inspektorët kanë vërejtur se këto masa zbatohen shumë pak. Gjatë qëndrimit në vend caktimin e patrullave për ndalimin e hyrje-daljeve në këtë qytet është vërejtur se zbatimi i këtyre masave është në nivel të papranueshëm. Gjatë qëndrimit të inspektorëve në pikën statike kontrolluese në hyrje të Klinës nga ana e Prishtinës është vërejtur një fluks i madh i hyrje-daljeve në mënyrë thuajse të pa penguar. Kontrolli policor është shtuar vetëm kur është vërejtur prezenca e inspektorëve. Situata e njëjtë është vërejtur edhe në katër pikat e tjera statike kontrolluese në Drejë, Dush, Jashanicë e Epërme dhe Leskoc. Zyrtarët policor në pikat kontrolluese në Komunën e Klinës kanë lënë një përshtypje sikur nuk e kanë të qartë rëndësinë e zonës karantinë dhe përgjegjësinë që kanë në ndalimin e hyrje-daljeve në qytet siç ishte shpallur me vendim të Qeverisë. Sipas vlerësimit të inspektorëve, qytetarët kanë lëvizur duke iu qasur zonës duke paraqitur arsye të thjeshta verbale. Paqartësi tjetër për zyrtarët policor ishte edhe prezantimi nga qytetarët i shumë formularëve të printuar nga web-faqja e ATK-së, por me vula të bizneseve, të cilat ishin të lëshuara në masë të madhe dhe të pa verifikueshme.

3.2.18. Zyrtarët policor të Stacionit Policor të Klinës kanë shprehur shqetësimet lidhur me pajisjen e tyre me masa mbrojtëse duke konsideruar se nuk realizohet furnizim i mjaftueshëm. Në shumicën e rasteve pajisjet mbrojtëse i sigurojnë në mënyrë vetanake. Dezinfektimi i automjeteve ishte jo i rregullt, duke u konsideruar edhe si i papranueshëm për situatën e krijuar.

3.2.19. Zonë e karantinuar ka qenë edhe Komuna e Zveçanit. Stacioni Policor i Zveçanit është vënë në zbatim të Urdhrit Operativ dhe bazuar në këtë janë adaptuar veprimet operationale në terren. Më 3 prill 2020, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndalimin e hyrje-daljeve të qytetarëve në Komunën e Zveçanit duke e shpallur zonë në karantinë. Si rezultat i këtij vendimi, Stacioni Policor i Zveçanit ka marrë masa në menaxhimin e situatës duke vënë në zbatim kapacitetet e plota të burimeve njerëzore. Pas situatës së krijuar në Komunën e Zveçanit, Stacioni Policor i Zveçanit ka aktivizuar orarin 12 orësh të angazhimit të personelit, duke vendosur edhe pika statike 24 h në mbulim të të gjitha rrugëve kryesore hyrëse-dalëse të qytetit, me qëllim të zbatimit të vendimit të Qeverisë. Pikat të cilat janë inspektuar kanë qenë të kompletuar me personel sipas orarit.

3.2.20. Gjatë inspektimit në terren për vlerësimin e zbatimit të masave lidhur me ndalimin e hyrje-daljeve së qytetarëve në zonën karantinë të Komunës së Zveçanit, inspektorët kanë vërejtur se këto masa zbatohen shumë pak. Në këtë Komunë, një patrullë e inspektuar ka qenë e vendosur sipas orarit në hyrje të qytetit me dy zyrtarë policor. Gjatë qëndrimit në këtë lokacion është vërejtur se zbatimi i këtyre masave ishte në nivelin e papranueshëm, ngase është vërejtur një fluks i madh i hyrje-daljeve në mënyrë thuajse të pa penguar. Edhe këtu, nga ajo që është vërejtur, qytetarët kanë lëvizur duke iu qasur zonës duke paraqitur arsye të thjeshta verbale, si dhe duke prezantuar disa vërtetime të pa verifikueshme, të cilat nuk ishin zyrtare për të lejuar hyrjen-daljen në këtë komunë. Në qytet është hasur edhe një patrullë në këmbë me të cilën nuk është realizuar kontakt. Inspektorët shfaqin shqetësim mbi mosmbulimin e aksit rrugor që shpie në Leposaviq me patrullë policore. IPK-ja ka inspektuar prezencën policore në rrugën Zveçan-Leposaviq deri në Banjaskë, me ç'rast nuk është hasur asnjë patrullë policore të angazhuar në zbatimin e masave për ndalimin e hyrje-daljeve në Komunën e Zveçanit. Kjo situatë kishte për rrjedhojë lëvizjen e lirshme dhe të pa kontrolluar të automjeteve.

3.2.21. Sa i përket masave për mbrojtje nga infeksioni, shqetësim i zyrtarëve policor edhe këtu ishte i njëjtë. Pajisja me masa mbrojtëse në kuadër të Stacionit Policor të Zveçanit ishte e nivelit jo të kënaqshëm. IPK-ja është njohur edhe me kërkesa zyrtare të shkruara për furnizime me këto mjete mbrojtëse. Në shumicën e rasteve, pajisjet sigurohen nga vet punonjësit e stacionit policor. Dezinfektimi i automjeteve të patrullave konsiderohej jo i mirë dhe i pa pranueshëm për situatën e krijuar.

3.2.22. Inspektimi i realizuar nga Departamenti i Inspektimit ka pasur fokusin edhe të zonës së karantinuar në fshatin Korishë, vendbanim ky në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor-Veriu Prizren. Stacioni është në zbatim të Urdhërit Operativ dhe bazuar në planet policore ka adaptuar veprimet operacionale në terren dhe funksionimin me kapacitete e nevojshme. Më 2 prill 2020, Ministria e Shëndetësisë ka marrë vendim për ndalimin e hyrje daljeve në fshatin Korishë, duke e shpallur si zonë në karantinë. Si rezultat i këtij vendimi, Stacioni Policor-Veriu Prizren ka marrë masa organizative në menaxhimin e kësaj situatë duke përdorur kapacitetet e plota të burimeve njerëzore. Ky Stacion është mbështetur edhe nga dy njësi të NJRKRR-Prizren dhe Stacioni Policor në Suharekë. Pas situatës së krijuar në këtë fshat, Stacioni ka aktivizuar orarin 12 orësh të punës, duke vendosur pika statike 24 h në mbulim të të gjitha rrugëve hyrëse dhe dalëse në fshatin Korishë me qëllim të zbatimit të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Pikat të cilat janë inspektuar janë hasur të kompletuara me personel policor sipas planifikimeve dhe orarit.

3.2.23. Gjatë qëndrimit në vend caktimin e patrullave për ndalimin e hyrje-daljeve në këtë fshat është vërejtur se zbatimi i tyre është në nivel jo të kënaqshëm. Në pikën statike kontrolluese në hyrje kryesore të fshatit është vërejtur se nuk kishte hyrje-dalje të pakontrolluara, por jo në mënyrë të kënaqshme. Kontrolli ishte shtuar vetëm atëherë kur inspektorët ishin prezent aty. Inspektimi kishte alarmuar Stacionin Policor-Prizren Veriu, ku bashkë me Qendrën Komanduese të DRP-Prizren, më 8 prill 2020 me një shkresë përmes e-mailit iu janë drejtuar patrullave në terren që të zbatojnë strikt rregullat e karantinës. Respektimi i masave të ndalimit të hyrje-daljeve në Korishë para inspektimit ka qenë në nivel jo të duhur. IPK-ja ka siguruar një dokument që dëshmon se nuk janë përfillur sa duhet masat e nevojshme. Për këtë situatë është alarmuar edhe Qendra Operative Emergjente. Shefi i urgjencës në Prizren me kërkesë iu ka drejtuar Qendrës Operative Emergjente në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë për marrjen e masave urgjente në zbatimin e rregullave të karantinës në Korishë. Në shkresë shprehet shqetësimi mbi qasjen e personave të paautorizuar në zonën e karantinuar të Korishës. Në pikat tjera statike kontrolluese në Korishë (Zona Industriale I, Kolegji Mehmet Akif, Internorm), inspektorët nuk kanë hasur në lëvizje të qytetarëve dhe të automjeteve për t'u qasur në zonën e karantinuar. Zyrtarët policor edhe në pikat kontrolluese në Korishë kanë lënë përshtypje sikur nuk kanë të qartë rëndësinë e zonës karantinë dhe përgjegjësinë në ndalimin e hyrje-daljeve në fshat siç ishte shpallur me vendim të Ministrisë së Shëndetësisë. Zyrtarët policor edhe këtu kishin paqartësi rreth vlefshmërisë të formularëve të prezantuar nga disa qytetarë, të printuar nga web-faqja e ATK-së me vula të bizneseve, të cilët ishin lëshuar në masë të madhe dhe ishin të paverifikueshëm. Duhet të përmendet këtu shqetësimi i zyrtarëve policor mbi dyshimet për abuzim me vërtetime për leje kalim, siç ishte edhe rasti i një biznesi individual (berber) ku me këtë formular dyshohet se kishte pajisur një numër të bashkëfshatarëve.

3.2.24. Zyrtarët policor në kuadër të patrullave policore nga radhët e Stacionit Policor- Prizren Veriu që kontrollojnë zonën e karantinuar të Korishës, në të shumtën e rasteve, pajisjet mbrojtëse i blejnë në mënyrë vetanake dhe përdorimi i tyre ishte në nivel relativisht të mirë. Dezinfektimi i automjeteve të patrullave ishte jo i rregullt dhe i pa pranueshëm për situatën e krijuar.

3.2.25. Zona e karantinuar e Komunës së Mitrovicës së Veriut që gjendet në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor-Mitrovicë Veriu është inspektuar vetëm në aspektet e respektimit të karantinës nga patrullat policore të Stacionit. Gjatë inspektimit të patrullave policore që sigurojnë perimetrin e zonës së karantinës të Komunës së Mitrovicës Veriu janë inspektuar gjithsej katër (4) patrulla të vendosura nëpër pika statike në të gjitha nyjet kryesore që lidhin territorin e kësaj komune me zona të komunave tjera. Lokacionet e këtyre patrullave kanë qenë në dy urat që lidhin pjesën jugore me atë veriore dhe një pikë kontrolluese me dy (2) patrulla në dalje të rrugës së qytetit Mitrovicë Veriu që lidhet me Komunën e Zveçanit. Të gjitha patrullat janë gjetur në lokacione siç është paraparë me orar. Gjatë inspektimit të pikave statike kontrolluese është vërejtur një fluks i madh i hyrjeve dhe daljeve në mënyrë thujse të pa penguar. Edhe prania e IPK-së në këtë pikë nuk ka ndikuar që të ndalet ky qarkullim i shpeshtë i qytetarëve. Qytetarët kanë lëvizur dhe iu kanë qasur zonës duke paraqitur arsye të thjeshta verbale, si dhe disa vërtetime të pa verifikueshme, që nuk ishin zyrtare që të lejojnë hyrjen-daljen në zonë. Është e nevojshme që kjo problematikë të adresohet menjëherë, në mënyrë që autoriteti drejtues i Policisë së Kosovës t'i ndërmarrin masat e nevojshme për eliminimin e të gjitha këtyre mangësive duke krijuar kushte që masat e parandalimit të përcaktuara nga vendimet e Qeverisë të respektohen në përpikëri.

3.2.26. Pjesëtarët e patrullave të inspektuar nga Stacioni Policor-Mitrovicë Veriu kanë deklaruar se jo rregullisht kanë mundësi të pajisen me pajisje mbrojtëse. Si në shumicën e stacioneve policore të inspektuara, shumë prej zyrtarëve policor janë deklaruar se shpesh këto pajisje detyrohen t'i sigurojnë vetë. Dezinfektimi i automjeteve policore nuk aplikohet rregullisht. Gjatë inspektimit të patrullave policore që sigurojnë perimetrin e zonës është vërejtur se personeli policor përdorë në masë jo të duhur pajisjet mbrojtëse.

3.2.27. Zona e karantinuar në Smrekonicë që gjendet në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor në Vushtri është inspektuar vetëm në aspektin e respektimit të karantinës. Gjatë inspektimit të patrullave policore që sigurojnë këtë zonë në karantinë, gjendja e gjetur në pikat kontrolluese nga IPK vlerësohet mjaft e mirë. Në këto pika statike nuk kishte hyrje dalje dhe as prani të qytetarëve për të kaluar nga një pjesë në pjesën tjetër të fshatit. Për shkak të situatës që tashmë dihet, edhe kjo zonë mbulohet 24 orë nga patrullat policore të Stacionit Policor të Vushtrrisë dhe Mitrovicë Jugut me orar 12 orësh. Të tre (3) patrullat policore të inspektuara janë gjetur me kapacitete të plota dhe në lokacionin e duhur sipas planit. Inspektorët vlerësojnë angazhimet dhe veprimet policore nga patrullat policore në zonën karantinë të fshatit Smrekovnicë duhet marrë si shembull se si duhet respektuar dhe zbatimuar masat e dala nga Qeveria e Kosovës për luftimin e Covid-19.

3.2.28. Zyrtarët policor të patrullave të inspektuara në zonën e karantinuar në Smrekovnicë janë deklaruar se deri diku pajisen me pajisje mbrojtëse (maska, dorëza dhe dezinfektues). Edhe këtu nuk aplikohet dezinfektimi i rregullt i automjeteve. Lidhur me aplikimin e masave mbrojtëse nga ana e patrullave policore që sigurojnë perimetrin e zonës është vërejtur se në masë të kënaqshme personeli policor përdorë pajisjet mbrojtëse.



### 3.3. Aktiviteti policor në stacionet policore kufitare

3.3.1. Me qëllim të parandalimit të infeksionit me Covid-19, me Vendim e datës 11 mars 2020, ndër masa e ndërmarra ishin edhe masat për pezullim të përkohshëm të linjave të udhëtimit ajror dhe tokësor nga vendet me risk të lartë dhe të mesëm, si dhe kontrolli i obliguar i udhëtarëve nga ekipet mjekësore në të gjitha hyrje-daljet e Kosovës, vetëkarantimi i detyruar për të gjithë qytetarët që hyjnë në Republikën e Kosovës nga zonat epidemike. Me qëllim të vlerësimit të zbatimit të këtyre masave, IPK-ja ka kryer inspektime dhe vizita në katër (4) stacione policore kufitare, përfshirë Vërmicën, Merdaren, Bërnjakun dhe Dheun e Bardhë. Në stacionet policore kufitare janë duke u zbatuar vendimet, urdhëresat dhe Urdhri Operativ për Gadishmëri dhe Reagim për Corona Virus-in Covid-19.

3.3.2. Gjatë kohës së inspektimit në stacionet policore kufitare, duke iu referuar informatave të vizitave të ekipeve të IPK-së në Vërmicë, Merdare, Dheu i Bardhë dhe Bërnjak gjatë datave 9 dhe 10 prill 2020, të gjitha stacionet kanë funksionuar me kapacitete të plota, me orar 12 orësh, përveç Stacionit Policor në Bërnjak, i cili aplikon orarin ditor 24 orësh. I gjithë personeli policor i këtyre stacioneve përfshihet në oraret e ndërrimeve, përveç rasteve të veçanta kur zyrtarët policor që vuajnë nga sëmundjet kronike, me rekomandim të Drejtorisë së Shërbimeve Shëndetësore ishin liruar nga puna. Në Vërmicë për shkak të aktiviteteve të kufizuara, një numër i zyrtarëve policor është angazhuar në asistencë në zonën e gjelbërt në kuadër të Stacionit Policor për Mbikëqyrje Kufitare në Vërmicë për ushtrimin e aktiviteteve patrulluese në parandalimin e kalimeve ilegale, të cilat janë shfaqur si dukuri pas kufizimeve dhe ndalimit të hyrje-daljeve në këtë pikë kufitare. Veç personelit policor në stacione policore, në kuadër të ndërrimeve prezent ishte edhe personeli doganor dhe personeli mjekësor, i cili shërben 24 orë për zbatimin e kontrollit mjekësor për të gjithë qytetarët që hyjnë në kufirin e Republikës së Kosovës. Sipas përgjegjësve të Policisë kufitare ekziston bashkëpunim i ngushtë me ekipet shëndetësore të vendosura në këtë pikë kufitare.

3.3.3. Në Stacionin Policor Kufitar në Vërmicë një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve policorë që punojnë në këtë stacion janë banorë që vijnë nga Komuna e Malishevës, zonë kjo e shpallur karantinë. Këta zyrtarë policor udhëtojnë çdo ditë nga kjo Komunë për të shkuar në punë në këtë Stacion. Duke pasur parasysh masat e vendimeve të Qeverisë, rekomandimet e institucioneve të shëndetësisë rreth funksionimit të zonave karantinë, autoritetet drejtuese policore, posaçërisht Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore, në aspektin profesional duhet të analizojë këtë problematikë, nëse lëvizja e vazhdueshme e këtyre zyrtarëve brenda e jashtë zonës së karantinuara, paraqet rrezik potencial për përhapjen e virusit tek personat tjerë.

3.3.4. Me qëllim të nxjerrjes së informacionit nëse masat e vendimeve qeveritare po respektohen, nga ekipet e inspektimit është vrojtuar ecuria e punës dhe qarkullimi eventual në hyrje të pikave kufitare. Brenda periudhës së inspektimit në këto pikëkalime kufitare është verëjtur se nuk kishte lëvizje të personave dhe automjeteve, përveç qarkullimit të mauneve për transportin e mallrave. Udhëheqësit e stacioneve policore kufitare deklaruan se nga data 17 mars 2020, kur janë aplikuar masat e kufizimit të qarkullimit të qytetarëve nëpër kufijtë e vendit, qarkullimi në hyrje-dalje lejohet vetëm për persona dhe automjete të cilave u lejohet lëvizja (hyrja-dalja).

3.3.5. Në stacionet policore kufitare, për çdo qarkullim në hyrje të kufirit aplikohen strikt masat parandalimit për kontrollet e qytetarëve. Çdo personi që i lejohet hyrja përmes pikave të kalimit

kufitar (ngasësit e automjeteve transportuese të mallrave ushqimore apo personeli mjekësor me autorizim të institucioneve të Kosovës), ndaj tyre së pari aplikohet ekzaminimi mjekësor sipas rregullave që kanë përcaktuar institucionet shëndetësore dhe pastaj vazhdohet me procedura të verifikimit dhe kontrollit kufitar. Në rast të hyrjes së shtetasve tanë në pikëkalim kufitar, ndaj tyre aplikohet ekzaminimi mjekësor dhe pas kryerjes së procedurave të kontrollit, verifikimit dhe regjistrimit kufitar, detyrimisht përcillen për karantinim në Qendrën e Studentëve në Prishtinë.

3.3.6. Të gjitha stacionet policore kufitare të inspektuara kanë ndarë hapësira të veçanta si dhoma karantinimi që shërbejnë për vendosjen e personave, të cilët dyshohen se mund të jenë të prekur nga virusi pandemik Covid-19. Secilit person që i lejohet hyrja në pikëkalim kufitar, i nënshtrohet kontrollit të detyrueshëm mjekësor në kufi. Pas ekzaminimit mjekësor poqëse konstatohet se tek ndonjëri shfaqen simptoma të ngjajshme me ato të infektimit me virusin pandemik, personat e tillë vendosen brenda dhomës karantinë. Qëndrimi i personave në këto dhoma është i kufizuar në kohë dhe zgjatë deri sa të organizohet transporti me ambulancë nën përcjellje policore, deri në Klinikën Infektive.

3.3.7. Inspektorët përveç zonave të karantiuara, kanë pasur interesim të njihen edhe me nivelin e aplikimit të masave mbrojtëse nga stacionet policore kufitare. Gjatë vizitave të realizuara nga IPK-ja, drejtursit e stacioneve kanë theksuar se deri në një masë janë furnizuar me pajisje mbrojtëse (dorëza, maska dhe dezinfektues), por jo edhe në masën sa të janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave të përditshme, kur dihet se këto pajisje janë për përdorim të kufizuar. Është gjetur se stacionet policore kufitare kanë mungesë edhe të veshjeve mbrojtëse (medicinale) komplecte, një përdorimshe, të nevojshme për përdorim nga stafi policor poqëse duhet të kenë kontakte fizike me persona të dyshuar të infektuar. Në Vërmicë, zyrtarët policor kanë deklaruar se shpesh këto pajisje detyrohen t'i sigurojnë vetë. Mosfurnizimi i mjaftueshëm i stacioneve me pajisje mbrojtëse, për zyrtarët policorë shfaq rrezik potencial të infektimit me virusin pandemik është në kundërshtim me rekomandimet e institucioneve të shëndetësisë. Edhe sa i përket dezinfektimit të hapësirave të punës së stacioneve policore kufitare, gjendja ndryshon varësisht prej nivelit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndër-institucional. Në Mirdarë, nga Komandanti i Stacionit ka deklaruar se këtë çështje e kanë zgjidhur me Komunën e Podujevës, ku dezinfektimi realizohet saherë shtrohen kërkesa për shërbime të dezinfektimit. Në Bërnjak, dezinfektimi i objektit dhe e hapësirave ishte bërë në fillim të muajit mars. Po ashtu, në këtë stacion ka ankesa në mbajtjen e higjenes dhe pastrimit të vazhdueshëm të objektit të stacionit dhe kabinave të kontrollit. Lidhur me këtë, zyrtarët policor kanë deklaruar se në stacion ka mungesë të personelit të pastrimit.

#### 4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

##### 4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor më 22.04.2020, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja u rekomandon Komandantëve të Stacioneve Policore që të ushtrjnë kontrolle më të shpeshta të zyrtarëve policor në kuadër të patrullave policore lidhur me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse gjatë punës, në kuadrin e masave parandaluese për luftimin e Covid-19.</i>	-I-	<i>Janë urdhëruar komandantët e Stacioneve policore dhe Drejtorët rajonal, që të bëjnë kontroll dhe inspektime të vazhdueshme në lidhje me zbatimin e masave mbrojtëse (dorëzat dhe maskat) nga vetë zyrtarët policorë. Po ashtu do të bëhet kërkesë Departamentit të Mbështetjes që të bëjë furnizimin me masa mbrojtëse për të gjithë zyrtarët policorë bazuar në nevojat operationale, në veçanti në zonat më të rrezikuara.</i>	<i>Urgjent/Tani veprime të ndërmarra nga stafi menaxhues.</i>
2.	<i>IPK-ja u rekomandon Komandantëve të Stacioneve Policore që të shtojnë kontrollet menaxheriale mbi patrullat policore për të ngritur seriozitetin dhe përkushtimin e tyre në zbatimin me përpikëri të masave të autoriteteve përgjegjëse lidhur me qasjen në zonat e karantinuara, drejt shmangies dhe minimizimit të rasteve të prekjes me virusin Covid-19.</i>	-I-	<i>Është kërkuar nga komandantët e Stacioneve Policore dhe Drejtorët Rajonal që të hartojnë planet e tyre mujore të inspektimit e në veçanti gjatë kohës sa të zgjatë urdhri operativ për menaxhimin e pandemisë COVID 19!</i>	<i>Urgjent/Është dërguar shkresa për hartimin e planit të veprimit për inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme.</i>
3.	<i>IPK-ja u rekomandon Komandantëve të Stacioneve Policore që të sigurojnë mbulueshmëri të duhur të rrugëve me pika kontrolli, përmes të cilave mund të mbikëqyret-kontrollohet qasja në zonat e karantinuara, në drejtim të luftimit të virusit Covid-19.</i>	-I-	<i>Në lidhje me këtë çështje duhet pasur parasysh që Policia e Kosovës është hera e parë që ballafaqohet me një detyrë specifike siç është karantina, po ashtu vështirësi ka paraqitur terreni gjeografik – pamundësia e mbulimit të hyrje-daljeve të shumta në një teren të caktuar. Megjithatë komandantët e stacioneve janë udhëzuar që të rishikojnë planet e tyre të mbulimit të terrenit dhe të</i>	<i>Urgjent/Do të rishikohen planet e veprimit lidhur me mbulimin e terrenit të secilit stacion policorë dhe nevojat për personel</i>

			<i>njoftojnë më qartazi policët në teren me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në pikat e caktuara që ndërlidhën me pandeminë.</i>	<i>shtesë për të mbuluar të gjitha pikat e nevojshme.</i>
4.	<i>IPK-ja u rekomandon Komandantëve të Stacioneve Policore dhe Drejtorëve Rajonalë që të ndërmarrin veprimet e menjëhershme në sigurimin e materialeve mbrojtëse, në mënyrë që personeli policor të jetë i pajisur rregullisht me maska mbrojtëse, dorëza dhe lëng dezinfektues, si dhe të aplikojnë dezinfektimin e rregullt të automjeteve dhe hapësirave.</i>	<i>-I-</i>	<i>Ky rekomandim është i qëndrueshëm për pjesën e parë të implementimit të planit operativ, ku stacionet policore kishin një numër të kufizuar të pajisjeve mbrojtëse të cilat janë siguruar si donacion nga komunat përkatëse. Më pastaj janë siguruar paisje të mjaftueshme nga Policia e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe partnerë të tjerë vendorë e ndërkombëtarë.</i>	<i>Në javët e ardhshme Departamenti i Mbështetjes-Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësor e duhet të siguroj paisje mbrojtëse në numrin e zyrtarëve policorë dhe nevojave qoftë përmes stoqeve apo kontratës.</i>
5.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit për Operacione që në cilësi të Udhëheqësit të Përgjithshëm të Operacionit për zbatimin e Urdhrit Operativ për Gadishmëri dhe Reagim për Corona Virus-in Covid-19, që të sigurohet se strukturat policore rajonale dhe lokale zërthejnë detyrat me udhëzimet e nevojshme për zyrtarët policor në terren në drejtim që këta të fundit të jenë të njohur me detyrat dhe veprimet konkrete në zbatimin e masave parandaluese në zonat e karantinuar.</i>	<i>-I-</i>	<i>Në lidhje me këtë janë dhënë shumë udhëzime me rastin e lëshimit për implementim të Urdhrit Operativ për Gatishmëri dhe Reagim për Corona Virus-in, gjithashtu janë lëshuar edhe shumë shkresa me udhëzime shtesë për njësitë policore të angazhuara direkt në teren.</i>	<i>Gjatë kësaj jave Drejtoria për Planifikim Permanent, të nxjerr një udhëzues të shkurtë xhepi me detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve policorë të angazhuar në pikat e kontrollit që ndërlidhën me karantinën.</i>